



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1937/8 prot.

Datë 14.08.2024

V E N D I M
Nr. 1047/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.08.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me tender kryesor me nr REF-03249-05-02-2024 me fond limit **3,660,634,272.00** lekë pa TVSh ku ankimohet procedura me Nr. REF-03258-05-02-2024, me objekt: “Lot3 Fentanyl”, me fond limit 19,194,616.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 03-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ankimues: “Evita” SHPK, me NIPT (L31714005J), me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Nr. Pasurie 7/120 – N1, Zona kadastrale 8270, Vol.28, Faqe 155, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me adresë: Rruga e Kavajës, Nr.1001, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: “Incomed” SHPK me NIPT (K91530017T), me adresë: SH56, Vaqarr

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga te gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomikë ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03-05-2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me tender kryesor me nr REF-03249-05-02-2024 me fond limit 3,660,634,272.00 lekë pa TVSh ku ankimohet procedura me Nr. REF-03258-05-02-2024, me objekt: “Lot3 Fentanyl”, me fond limit 19,194,616.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 03-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2. Në datën 03.06.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 02.07.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1-“Incomed” SHPK	7,637,336.00	lekë pa TVSH	kualifikuar
2-“E V I T A” SHPK	13,774,481.00	lekë pa TVSH	kualifikuar
3- “Partners Pharma” SHPK	15,118,808.00	lekë pa TVSH	kualifikuar
4- “Luviv” SHPK	19,048,139.44	lekë pa TVSH	kualifikuar

II.4. Në datën 08.07.2024 është publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të Fituesit” për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 15.07.2024 operatori ekonomik “E V I T A” SHPK ka paraqitur ankese me nr ankimi elektronik me nr. A/2024/4327, datë 15.07.2024 dhe me nr. protokoli 1937/2024 datë 16.07.2024 ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Incomed” SHPK duke pretenduar: *“Rezulton se oferta e paraqitur nga OE Incomed është anomalisht e ulët në zbatim të nenit 82, pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar [...]”*

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 1937/2 prot., datë 17.07.2024.

II.7 Me anë të shkresës me Nr.1989/49 prot., datë 26.07.2024 , protokolluar me tonën me nr. 1937/3 prot., 29.07.2024 me lëndë “Dergim i Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës” është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues nga ku rezulton që autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik “Evita” SHPK.

II.8. Me anë të shkresës ardhur në sistem me Nr.1989/49 prot., datë 26.07.2024 , protokolluar me tonën me nr. 1937/4 prot., 29.07.2024 me lëndë “Dergim i Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës” është ngarkuar nga autoriteti kontraktor informacioni në lidhje me

ankesën e operatorit ekonomik ankimues nga ku nga ku rezulton që autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik “Evita” SHPK.

II.9 Me anë të shkresës datë 31.07.2024 me lëndë “Sqarime shtesë në lidhje me ankesën e depozituar me nr. Aplikimi të ankesës online A/2024/4327, nr. prot. 1937/2024, datë 16.07.2024 për fazën e vlerësimit të procedurës me nr. REF-03258-05-02-2024, zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1937/5 prot., datë 01.08.2024 operatori ekonomik “Evita” SHPK ka paraqitur sqarime shtesë lidhur me vendimin e KSHA-së.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “EVITA” SHPK me nr.1937/2024 prot., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Evita” SHPK per operatorin ekonomik “Incomed” SHPK ku pretendon se *“Rezulton se oferta e paraqitur nga OE Incomed është anomalisht e ulët [...] përkatësisht duke shprehur se”* Ë rrethanat e mësipërme, në përgatitjen e ofertës sonë, ne kemi marrë në konsideratë këtë dinamikë të përcaktimeve ligjore, duke u kujdesur që që të mos rrezikojmë refuzimin automatik të ofertës anomalisht të ulët, ndërkohë që nga ana e KVO, OE i shpallur fitues i është dhënë mundësia ta argumentojë këtë ofertë, edhe pse duhet ta kishte refuzuar pa kërkuar sqarime ..” KPP vëren se,

III.1.2 Referuar Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përkatësisht Neni 34 pika 1 dhe 7 përcaktohet se:

1. Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u

jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t'i mbajë ato parasysht kur përllogarit vlerën e prokurimit.

7. Kur një punë, mall ose një shërbim mund të rezultojë në dhënien e disa kontratave në formën e loteve të veçanta, duhet të merret parasysht vlera e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve.

III.1.3 Në nenin 12 “Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *8. Kur një punë, mall ose shërbim mund të rezultojë në dhënien e disa kontratave në formën e loteve të veçanta, për qëllim të përllogaritjes së vlerës së kontratës, duhet të merret parasysht vlera e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve.*

III.1.4. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

III.1.5. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Pas korrjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- *Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
- *Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*
- *Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.*
- *Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.*

III.1.6 Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Incomed” SHPK nga përlllogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta ekonomike në vlerën prej 7,637,336 lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 dhe 5 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit.

Në rastin konkret, nuk ndodhemi në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të LPP-së se: *në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët*”, pasi procedura e prokurimit objekt – shqyrtimi lidhur me lotin perkatës e ka fondin limit 19,194,616 pa TVSH por nderkohe referuar nenit 18 të VKM pika 8 ne përlllogaritjen e vlerës së kontratës, duhet të merret parasysh vlera e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve. Ndaj referuar kësaj baze ligjore KPP, vëren se në rastin konkret Fondi Limit i Tenderit Kryesor është **3,660,634,272.00 lekë pa TVSH** vlerë e cila rezulton mbi kufirin e lartë monetar, referuar nenit 11 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, i ndryshuar, ku thuhet se: *Në përputhje me nenin 33, të LPP-së, kufijtë monetarë janë:*

a) *Kufiri i lartë monetar:*

- 650 000 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 40 000 000 (dyzet milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

b) *Kufiri i ulët monetar:*

- 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara, ndaj referuar sa me sipër ndodhemi para faktit se autoriteti kontraktor ka vepruar konform bazës ligjore të sipërsituar pasi Fondi Limit i procedurave se përgjithshme është 3,660,634,272.00 lekë pa TVSH ku rezulton se kjo procedure është mbi kufirin e lartë monetar, dhe duke patur parasysh faktin se për afatet mbi ankesat ndiqet e njëjta llogjike procedure ku nuk merret parasysh loti respektiv cila ankimohet por Fondi Limit i përgjithshëm ku behet ndarja e kufijve monetar, dhe në bazë të kësaj të fundit vleresohen hapat procedural qe ligji 162/2020 i Prokurimit Publik parashikon.

Ndaj KPP Vlerëson se autoriteti kontraktor me hapat procedural që ka ndjekur lidhur me oferen anomalisht të ulët të operatorit ekonomik “Incomed” SHPK është i drejtë, pasi procedura e përgjithshme me tender kryesor rezulton të jëtë më vlerë 3,660,634,272.00 lekë pa TVSH, ku sipas kësaj vlere referuar kufijve monetar në bazë të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, jemi në një procedure prokurimi ku kufiri monetar klasifikohet “mbi kufirin e lartë monetar” e për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të ndjeko hapat procedural duke patur detyrimin t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e shpjegimeve për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë, të parashikuara në nenin 93, pika 1 dhe pika 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Pra nga sa më sipër rezulton, se autoriteti kontraktor ka ndjekur hapat proceduralë të parashikuara në nenin 93, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku thuhet se “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë, ndaj theksojme se për procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, siç është rasti në fjalë, autoriteti kontraktor kërkon shpjegime lidhur me ofertën anomalisht të ulët.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Evita” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Incomed” SHPK me arsyetimin se: “Në kontekst të njohjes dhe vlerësimit të tregut farmaceutik dhe produkteve të disponueshëm, në

vlerësojmë se pavarësisht nga shpjegimet që mund të ketë dhënë për ofertën anomalisht të ulët, OE Incomed, nuk mund të ketë arritur të përmbushë në mënyrë kumulative, dhe të shoqëruar me provat përkatëse, kërkesat e nenit 93 (2) të LPP. MË konkretisht, kjo dispozitë kërkon që të jepen shpjegime në mënyrë kumulative për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të për zgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; Á) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; Ne kemi dyshime që OE Incomed shpk, nuk ka justifikuar ofertën e tij anomalisht të ulët, sa i takon të gjithë komponentëve të nenit 93 të LPP-së si më sipër. Operatori ekonomik duhet të analizojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit/procesit të prodhimit ose të produkteve të ofruar, duke argumentuar të gjitha kostot e nevojshme duke përfshirë këtu kostot direkte (cmimin e blerjes së produktit në import në CIF), si dhe kostot indirekte (kosto e punës, administrative e operative). Operatori ekonomik duhet gjithashtu që të argumentojë zgjidhjet teknike të ofruara ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm. Gjithashtu mendojme se edhe origjinaliteti i mallit nuk është provuar prej tij nëpërmjet dorëzimit të certifikatave të analizës të produktit të ofruar. Përsa më sipër, edhe nga pikëpamja përmbajtësore, oferta e OE Incomed, duhet të refuzohet si ofertë anomalisht e ulët e paargumentuar.

III.2.2. Me dokumentacionin e administruar pranë KPP nga ana e autoritetit kontrkaotr lidhur me argumentimin e ofertes ekonomike anomalisht e ulet e operatorit ekonomik “Incomed”SHPK me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka paraqitur në mënyrë shkresore dokumentacionin si më poshtë:

Lenda: Kthim pergjigje informacion për ofertën anomalisht të ulët

*Në lidhje me kërkesën për informacion të bërë nga ana juaj për ofertën e paraqitur nga kompania jonë për barin Lot3 Fentanyl 50 mcg/ml – 10 ampule, REF- 03258-05-02-2024, në procedurën e prokurimit me object “**B1 - Blerje barna sistemet Anestezi reanimacion, Anti tuberkulare, Antineoplastike dhe imunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna dermatologjike, Barna hormonale sistemike, Lëndë kontrasti për CT, Lëndë kontrasti për MRI, Lëndë kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës, Organet e shqisave, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular**”, ndarë në 115 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 3,660,634,272 (tre miliard e gjashtëqind e gjashtëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH” Ref-03249-05-02-2024, zhvilluar në datë 03.06.2024.*

Mbështetur në nenin 93 të LPP, më poshtë po ju japim sqarimet e nevojshme për cmimin e ofruar nga ana jonë duke specifikuar elementët e veçantë të ofertës:

Kompania Incomed SHPK me NIPT K91530017T deklaron se kompania HAVER FARMA ILAC A.S – TURQI si prodhues dhe mbajtës I Autorizimit për tregtim I barit Fentanyl 50 mcg/ml – 10 ml (Fentaver) ka miratuar pjesëmarrjen dhe ofruar në këtë procedurë prokurimi një cmim të favorshëm ekonomik duke e konsideruar të rëndësishëm faktin që kjo është një procedurë e qëndrueshme, me perspektivë afatgjatë dhe me një sasi të konsiderueshme. Në përgjigje të kërkesës tuaj për sqarim theksojmë se:

- 1. Ccmim i ofruar nga Incomed shpk, I autorizuar nga MAH për Fentanyl 50 mcg/ml-10 ml (Fentaver) nga kompania HAVER FARMA ILAC AS Turqi është 98 (nëntëdhjetë e tetë) lekë/ampulë. Ky cmim është vendosur pas analizës së kostos me një marzh fitimi të pranueshëm, duke përfshirë elementët përbërës si cimin e blerjes, transportin dhe të gjitha shpenzimet e tjera operative për këtë procedurë, deri në dorëzimin e medikamentit pranë cdo autoriteti kontraktor.*
- 2. Theksojmë se kjo ofertë nuk konsiston në ndryshimin e kostove të prodhimit, duke ruajtur cilësinë dhe garancinë e medikamentit.*
- 3. Kjo ofertë është vendosur duke marrë në konsideratë qëndrueshmërinë, seriozitetin, kontratat afatgjata me AK, historikun e bashkëpunimeve dhe kostot e pakta operative, të kësaj procedure në ndryshim nga shitjet e realizuara në spitale dhe klinika private, ku për arsye të specifikave që ka ky treg ka kosto më të larta transporti, rrisht I madh likuiditeti, risk me të madh për humbje nga skadencat etj. Duke analizuar sa më sipër ne vendosëm të ofertojmë me këtë cmim të favorshëm, ccmim I cili është Brenda elementëve të ofertës, si atë ekonomike, teknike të furnizimit dhe conform legjislacionit fiscal në RSH.*
- 4. Kjo ofertë nuk çënon origjinalitetin e medikamentit I cili është regjistruar pranë AKBPM dhe pajisur me autorizim për tregëtim, I cili kontrollohet në cdo detaj për ccdo import të kryer nga AKBPM duke siguruar kështu furnizim të sigurt Brenda afateve kohore dhe kushteve të punës duke dhënë garanci tonë të plotë që bari I ofruar është prodhuar me standarte të larta duke plotësuar të gjitha specifikimet e përcaktuara në dokumentacionin shoqëruar të ofertës.*
- 5. Për sa më sipër bashkëngjitur gjeni deklaratën e kompanisë + proforma invoice e cila miraton cimin e blerjes për këtë medicament për këtë procedurë.*
- 6. Bashkëngjitur do të gjeni:*
 - Deklaratën nga kompania HAVER FARMA ILAC AS TURQI*
 - Proforma Invoice.*

Incomed shpk është nga kompanitë farmaceutike në vend, me një aktivitet fleksibël dhe të sukseshëm në fushën e prokurimeve ndër vite, gjë që e vërteton realizimin kontratave me sukses Brenda afatit kohor të lëvrimin dhe në vlerën e plotë në përputhje me kushtet e vendosura në to, sipas kërkesave të spitaleve si autoritete kontraktore gjë që vërteton se ne plotësojmë dhe zotërojmë të gjitha kapacitetet teknike, financiare, mjetet, stafin, systemin e menaxhimit të cilësisë dhe cdo aspect tjetër Teknik të nevojshëm për realizimin e kësaj procedure si dhe kemi të gjitha aftësitë për të kryer furnizime në kohë dhe shpejt tek të gjithë AK, të cilat funksionojnë normalisht në shërbim të pacientëve.

III.2.3. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: *“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [....]”

III 2.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPPsë.*
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shpresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.*

III.2.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Incomed” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën 7,637,336 lekë pa TVSh , në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomik për ofertën anomalisht të ulët duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nga ku katër kushtet e

para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë *mundësinë* e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KPP gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “*Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar

formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe *mundësinë* për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.2.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Incomed” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative dhe gjithashtu me prova dhe fakte lidhur me percaktimin e kostos për produktin e kërkuar. Nga oferta ekonomike e ngarkuar në sistem vërehet se operatori ekonomik ka ngarkuar ofertën me vlerë 98 leke cmim për njësi. KPP gjykon se, operatori ekonomik “Incomed” SHPK përveç argumentimit të vet në formën e një narrative ka paraqitur prova shprehëse për elementet e ofertës sikurse kërkuar, pranë autoritetit kontraktor.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e operatorit ekonomik ankimues është dorëzuar dokumentacioni provues mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi duke përmbushur kështu kushtet e rëndësishme kumulative të parashikuara nga neni 93 i LPP-së. KPP gjykon se operatori ekonomik ka justifikuar ofertën e tij duke sjelle dokumentacionin nga Komania HAVER FARMA ILAC A.S lidhur me **koston e produktit bashke me Cmimin CIF**. KPP gjykon se shpjegimi narrativ dhe dokumentacioni provues nepermjet shprehës së datës 27.06.2024 janë prova të mjaftueshme në kuptim të dispozitave ligjore në fuqi, si dhe mjaftojnë për krijimin e bindjes, se operatori ekonomik “Incomed” SHPK disponon kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës objekt-prokurimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Evita” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Evita” SHPK “, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me tender kryesor me nr REF-03249-05-02-2024 me fond limit **3,660,634,272.00** lekë pa TVSh ku ankimohet procedura me Nr. REF-03258-05-02-2024, me objekt: “Lot3 Fentanyl”, me fond limit 19,194,616.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 03-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Evita” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

